Vdekje fashizmit — Liri Popullit

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

DEL DY HERE NE JAVE: [illegible]TEN DHE TE DIELLEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Drejtori pergjegjes SEDAT DIDA

Vjeti IV Nr. 168 | PRISHTINE, e ejte 16 Dhetuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

PARA KONGRESIT TE II TE PKS DHE KONFERENCES SE IV KRAHINORE

Brigadat e Punes te Frontit populluer punojne me vetmohimin per plotesimin detyrve te veta

Brigadat e Frontit populluer ne Krahinen t'one kane korre sukses e kane arrijte rezultate t'mira, te cilat me te vertete e ngrejne ma nalt prestigjin e organizates se Frontit populluer. Nji pjesemarrje ekonomike e kane rritur planin te tyne vjetuer [illegible] qe kane dhane brigadat punore te Frontit populluer. Brigadat e frontit kane ndihmue shum ne shfrytezimin e pyjeve, ne punet bujqesore etj.

Brigadat speciale jane ba formet ma te perdhinshme te [illegible] ne menyre masovike te fuqise punetore. Nepermjet [illegible] te brigadave asht [illegible] eksperienca, e cila po ndihmon ne realizimin e Planit t'one Pesevjeçar. Neper brigadat te punes te frontit populluer ma se miri po perfshihen masat katundare ne ndertimin e socjalizmit ne atdheun t'one.

Ne krahinen t'one asht ne formimin e tyne punojne 22 brigada te frontit populluer, prej te tyne per punen e vetmohueshme jane propozue nji te shijli ekzekutiv i Frontit Populluer te Kosmetit, prane keshillit kryesuer te frontit te Serbis per me u deklarue sulmuese kto brigada.

Brigada e pare e rrethit te Dragashit, qe punon ne ndrequjen e hekurudhes Metohi Prizren, per heren e pare sulmuese; brigada e III te Gjilanes, e cila ka punue ne prerjen e druve ne pyllin e Deçanit, kjo brigade per heren te dyte del sulmuese; brigada e dyte e Prishtines, qe punon ne ndertimin e hekurudhes se minjeres Obiliq — Bellaqevc, per heren e pare sulmuese; brigada e pare e Rahovecit qe punon ne hekurudhen Metohi — Prizren per heren e pare sulmuese; brigada e dyte e Suharekes e cila punon po ne ket hekurudhe, per heren e pare sulmuese; brigada e peste e Lipjanit qe punon ne hekurudhen e minjeres Kosove — Bellaqevc per heren e pare sulmuese dhe brigada e Gjakoves qe ka punue ne minjeren e Leposaviqit per heren e pare sulmuese.

Te konferences se IV-te te Partis Komuniste te Serbis per Kosmet. Neper keto konferenca kane marre pjese ma se 13.000 persona. Veç kesaj, asht mbajte nji miting per Kongresin e Dyte te PK te Serbise dhe te konferences se IV-te PK te Kosmetit Ne ket miting kane marre pjese 1.500 antare te Frontit.

GJate nandorit asht formue nji brigade prej 100 antaresh te Frontit, e cila punon ne minjeren e Trepçes.

Me 1 te ketij mueji sipermarrja „Shtedim" ne Peje e ka realizue planin vjetuer me 121 per qind

Sipermarrja e ndertimeve „Shtedim" ne Peje, ka arrijte gjate ketij vjeti rezultate te mira ne plotesimin e detyrave te veta te prodhimit simbas planit te parapam. Deri me 1 dhetuer te ketij vjeti i tane kolektivi punues i sipermarrjes e ka tejkalue planin vjetuer me 21%. Ne te gjitha vendpunimet e sipermarrjes jane caktue normat e punes, keshtu qe sipermarrja „Shtedim" e Pejes, perkah organizimi i punes, asht nji nga sipermarrjet ma te mira te ndertimit ne Krahinen t'one.

Rinija e Krahines s'one e pret me rezultate te mdhaja Kongresin e perbashket

Rinija e Krahines s'one po e pret me rezultate te mdhaja punoje te mbrritjuna gjate ketij vjeti Kongresin e perbashket te SKOJ-it dhe te Rinis popullore te Jugosllavis. Keto rezultate jane arrijte ne saje te punes se perforcueme dhe te hovit punues te Rinis se Krahines s'one, gja qe asht shprehe ma se miri ne garat e zhvillueme ne ndere te Kongresit te Peste te PKJ, kongresit te IV-te te SKOJ-it dhe te Rinis popullore.

Ne ndertimin e Autostrades, Beogradit te ri, fabrikes ne Zhelezník dhe neper aksjonet e ndryshme me karakter federativ dhe republikan, kane marre pjese deri tash 10.717 te rij e te reja, prej te cilve 906 jane shpalle sulmues. Perveç kesaj Rinija popullore e Kosoves dhe e Metohis ka ndertue gjate ketij vjeti dy rrugë pyjore industrijale me karakter krahinor, dhe nji brigade ka punue gjate gjithe veres per rregullimin e [illegible] te Rinis ne Landovice. Ne keto aksjone kane marre pjese 1.300 te rij e te reja prej te cilve 135 jane shpalle sulmues.

Kontributi te madh ka dhane Rinija e jone edhe per ndertimin e shtepijave kooperative. Ne ket aksjon Rinija ka dhane 1.[illegible] ore pune vullnetare.

Prej 48 brigadave te cilat kete vjet kane marre pjese n'aksjonet e ndryshme ma te mdhaja, 12 prej tyne jane shpalle njihere sulmuese, 16 dy here, dhe [illegible] here, gjashte-kater here, dy-pese here dhe nji-gjashte here sulmuese.

Rezultate ma te mira ka korre brigada e trete e Zveçanit, e cila asht shpalle gjashte here sulmuese. Kjo ka punue ne ndertimin e Autostrades. Gjithashtu ka korre rezultate ma te mira edhe brigada e rrethit te Graçanices, e cila asht shpalle pese here sulmuese ne punen per ndertimin e Beogradit te ri.

Kujdes i veçante i asht kushtue edhe punes ideo-politike ne mes te Rinis si dhe ngritjes se saje profesjonale dhe kulturale. Gjate ketij vjeti jane formue ne Krahine 1.622 rrethuj per punen ideo-politike. Ketu jane perfshi 21.000 te rij e te reja, prej te cilve shumica jane shqiptare. Ne luften kundra analfabetizmit Rinija ka korre gjithashtu rezultate te mira. Nepermjet te kurseve analfabetike jane mesue me shkrue e kendue 12.941 te rij e te reja.

Gjate ketij vjeti organizatat e Rinis popullore ne Krahinen t'one asht te formue organizativisht. Vetem gjate 11 muejve te fundit jane perfshi 11.277 antare te ri n'organizaten e Rinis popullore jane formue 91 aktive te reja neper katunde te sipermarrjet, ku nuk kane egzistue ma pare.

Fronti populluer i Dragashit ne lufte per realizimin e detyrimeve

Fronti populluer i rrethit te Dragashit i asht pervesh punes me mish e me shpirt per me i kry premtimet e marruna persiper ne ndere te Kongresit te II-te te PKS te ket e [illegible] ma se miri rezultatet e arrijtuna gjate zhvillimit te garave ne ket rreth.

Nga puna e vetmohueshme e frontistave te ketij rrethi jane arrijte rezultate te kenaqshme ne keto pika:

Mbledhjet jane krye ne te tane rrethin simbas planit te parapam;

Jane perfshi ne kurset analfabetike te gjithe analfabetet;

Asht mbledhe antarsija nga te gjitha organizatat e frontit ne krejt rrethin;

Te gjitha shkollat qe punojne jane furnizue me dru, me ket rast frontistat e ketij rrethi kane dhane 380 dite pune me nji vlefte prej 38000 dinar;

Kane dergue ne hekur-udhen Metohi Prizren 36 puntor per me e plotsue numrin e nevojshem te brigadave;

Per ndertimin e shtepijave kooperative kane dhane 848 ore pune me nji vlefte prej 8490 dinar, dhe nga anen e kafshve 304 ore me nji vlefte prej 91.200 dinar;

Jane vjelle prej pyjeve 177 copa lande te mdha te cilat kane nji vlefe prej 88500 dinar;

Asht krye pagesa e tatim fitimeve;

Jane parapague ne fletoren „Rilindja" ne menyre kolektive dhe shumica prej tyne jane abonue individualisht;

Jane hap dy salla leximi, te cilat me rastin e permenduni kane me fillue te funksjonojne;

Asht shtue numri i te rregjistrueme ne kooperativa.

Ket shembull duhet t'a ndjekin edhe keshillat e frontit populluer te Krahines t'one.

Korre rezultate te mira ne pune per realizimin e planit vjetuer. Me gjithe te [illegible] brigadat punojne rregullisht ne vendpunimet e veta. Ne keto rrethe e fundit jane krye disa objekte te parapame ne planin investicjonal.

Deri me daten 10 te ketij muaji sipermarrja e ka realizue planin vjetuer me 98%, e perveç kesaj jane ploteue te gjitha detyrat e marruna persiper [illegible] planit.

Ne ndere te Kongresit te II-te te Partis Komuniste te Serbis dhe te Konferences se IV-te Krahinore te PKS per Kosmet te gjithe puntoret dhe nepuntoret e kesaj sipermarrje kane hy ne gara ne mes tyne per mbritjen e rezultateve sa ma te mira. Çdo puntor ka marre persiper me plotesue normen e vet ne 100%.

Kolektivi punues i sipermarrjes „Sitnica" korre perfundime te mira

Kolektivi punues i sipermarrjes se ndertimeve „Sitnica" ne Mitrovice, tue i plotesue premtimet te dhanuna po

Puna vetmohuese n'akcionet e ndryshme te Frontit populluer ne rrethin e Drenices

Gjate muejit nanduer organizatat e Frontit populluer ne rrethin e Drenices kane arrijte rezultate knaqshme ne te ndryshme. Antaret e Frontit jane dallue sidomos ne mbjlljet e vjeshtes, ne ndertimin e shtepijve kooperative dhe ne sigurimin e disa qinda metrash dru zjarri per institutet shtetnore.

Kujdes i madh i asht kushtue dhe punes ideo-politike dhe asaj kulturo-arsimore. Vetem gjate muejit nanduer jane mbajte ma se 200 konferenca ne lidhje me problemet a ndryshme, kryesisht ne lidhje me krijimin e koperativave katundare te punes, ne perpunimin e materjalit te Kongresit te Partis te PKJ, mbi randesin e 29 Nandorit-dites se shpalljes se RFPJ-s si dhe per garat e shpalluna ne ndere te Kongresit te Dyte te Partis Komuniste te Serbis dhe per ndere

Kolektivi punues i fabrikes se tullave dhe tjegullave ne Prishtine ka korre suksese ne prodhim

Kolektivi punues i fabrikes se tjegullave e tullave ne Prishtine planin vjetuer te tullave te punueme e ka realizue 100% deri ne fund te muejit nanduer, planin e tulles se pjekun me 82%, kurse ate te tulles se doret me 92%. Tue marre parasyshe prodhimin e vjetit te kaluem te tullës se punueme, mbrrijhet te konstatohet se ne ket vjet ky prodhim asht shtue me 365%, ndersa ai i tulles se pjekun me 300%. Ket sukses e ka ba te mundeshem organizimi i mire i punes, eksperienca qe kane fitue puntoret ne te kaluemen, agitacjoni i perdhshem dhe organizimi i mire i garave socjaliste.

Ne ket vjet cikli i punes se nji puntori ne krahasim me vjetin e kaluem asht permiresue me 50%, e kjo i [illegible] organizimit dhe [illegible] te drejtoris se sipermarrjes. Ne zbritjen e çmimit te plote te kushtimit planit asht realizue 100%, derisa ne vjetin e kaluem per 1.000 copa tulla shpenzoheshin 0.25 kat. tone, ne ket vjet ne vend te tunes asht shtie ne perdorim hini i torres. N'anen tjeter me ç'rrytezimin racjonal asht arrijte te bahet nji kursim i madh ne karburante e lande tjera djegese; gjithashtu asht pakesue shum djegja e tullave etj. Ne ket menyre puntoret t'one populluer i kane kursye 150.000 dinare.

Krahas me shtimin e hovit te punes nga ana e puntoreve, njikohesisht asht shtue edhe mediija e puntoreve prej 4—5 dinare, n'ore.

Per me e permiresue prodhimin e ketij vjeti, kolektivi punonjes i kesaj fabrike ka mbajte 70 konsultime, ku asht diskutue rreth menyrave dhe formave te ndryshme te punes per nji kualitet ma te mire. Ne keto konsultime jane pranue nji seri prodhimesh ne lidhje me shpejtimin e procesit te punes. Kualifikimit te puntoreve ne ket sipermarrje i asht kushtue nji kujdes i posaçem, keshtu qe gjate ketij vjeti jane kualifikue 12 puntore.

Puntoret e kesaj fabrike me punen e tyne vullnetare jashta orarit te punes kane prodhue 29.000 tulla te pjekuna, per nevojat e shtepijave kooperative te rrethit te Prishtines e 90.000 tulla te klases se dyte per rregullime te banesave private etj.

Sipermarrja ne ket fabrike ne marreveshtje me degen sindikale te saje per sukseset e arrijtuna ka shperblye 12 puntore me 25.000 dinare, kurse 20 te tjere kane marre lavdata per punen e tyne te vetmohueshme.

ga dhe Millosh Zogoviq. Keta te gjithe e kane tejkalue normen me 25- 85 per qind. Per novator u-shpalle Radovan Miqeviqi. Ky i ka mbatue disa thika per frezmaqina, me anen e te cilave ka arrijte me e shtue prodhimin e „futerit" per 100 per qind, kursimin e landes me 5 per qind, te materjalit tjeter, tutkallit etj. me 70 per qind. Puntoret e ketij kombinati kane hape kandin e kuq, te cilin e kane kompletue me mobiljet e nevojshme, me radio aparat dhe biblioteke solide. Kandi i kuq asht parapague ne fletoret: Rad, Borba, Rilindja, Jedinstvo, etj.

Ka ma se nji vjet qe ky kolektiv e mban vazhdimisht flamurin kalimtar te keshillit sindikal te rrethit.

Ne kombinatin e zejtarve ne Peje u-shpallen 5 sulmues dhe nji novator

Prane kombinatit te zejtarve ne Peje asht mbajte konferenca solemne me rastin e festes se 29 Nandorit dhe me kete rast jane vue ne dukje sukseset e korruna ne punen e deritashme nga mbare kolektivi punues i ketij kombinati. Me kete rast u-shpallen per sulmues 5 puntor dhe nji tjeter u-shpall per novator, e tridhet te tjere u-lavdruen dhe u-shp rblyen: Per sulmues u-shpallen: Voja Vuçetiq, Trajko Stergjeviq, Tomo Kariq, Nikolla Ge-

SERBICE

Asht per t'u vue ne dukje se ne disa keshilla vendesh te rrethit te Serbices asht ba zemundje, vonesa e shperndamjes se gazetave te ndryshme si dhe e akteve zyrtare. Keto keshilla, posa t'a marrin posten, nuk kujdesohen qe te praktikohet ekspeditiviteti, por mbesin paketa ndertuar e ndryshme te zyrave. Si shembull konkret e te freskët kemi aktin e seksjonit t'arsimit te rrethit te Serbices, i cili i ka ra ne dore mesuesit te shkolles Karaticez mbas 11 ditesh.

Rreth ndertimit te shtepijave kooperative ne rrethin e Suharekes

[illegible]

Shperblime per luftetaret per produktivitet ma te nalte

[illegible]

Ne Krahinen t'one jane shpue deri tash 2.217 bujqe ne luftë per produktivitet ma te nalte dhe 28 luftetare u shperblye per prodhime sa ma te nalta. Ketu jane shperndaje me shuma prej 64.000 dinarash.

Nga mbledhja je dergue nji telegram pershendetes Marshallit te Jugosllavis Josip Broz — TITO, ne te cilin thuhet:

„Shok Marshal.

Nga mbledhja e jone e pare, luftetaret per prodhim ma te nalte nga Kosmeti te dergojne pershendetje te nxehta, tue ju premtue se ne vjetin e ardhshem do te perpiqemi edhe ma teper per punimin ma te mire te tokes dhe per rritjen e kulturave bujqesore me qellim qe t'a shtojme prodhimin sa ma teper, mbassi bujqesija ne Krahinen t'one asht mjaft e mbrapambetun, e keshtu me kete masa duhet t'a bajme nji hapje drejt perparimit te bujqesis ne Krahinen t'one, t'a ndihmojme direkt popullin t'one punues ne kryemjen e detyrave te Planit te pare pesvjeçar te Titos.

Te zotohemi se me luften t'one per produktivitet ma te nalte do t'a masovizojme ket aksion edhe ne vjetin e ardhshem si dhe ne vjetet e tjera ...

Ma shum kujdes per sigurimin e druve

[illegible]

Konstatimet e komisjonit kontrollues te rrethit te Liplanit

[illegible]

FERIZAJ!

[illegible]

Pse te lejohet qe te pengohet transportimi i drithit prej rrethit te Drenices

[illegible]

R. SH.

Internati i shkolles normale dhe gjimnazit te Gjakoves ne gara me te gjithe internatet e Krahines s'one

[illegible]

R. Kabashi

Nga konferenca sindikal'e e arsimtareve te Pejes

[illegible]

Arsim e kulture

T'a forcojme fushaten e organizimit te kurseve analfabetike ne disa rrethe te Krahines s'one

Ne te gjithe rrethet e Krahines s'one pergaditjet e fushates se li[illegible] [illegible] jane ba me kohe. Neper kurset per udheheqsat e kurseve analfabetike, te cilet jane mbajt ne muejt shtatuer e tetuer te ketij vjeti jane aftesue 1.100 udheheqsa te kurseve analfabetike. Mbas organizimit te komisjoneve per likuidimin e analfabetizmit asht krye regjistrimi i pergjithshem i analfabetve. Gjithashtu jane krye pregaditjet teknike per fillimin e rregullt te punes neper kurset analfabetike. Me udhezimet e Drejtoratit arsimuer te Keshillit krahinuer kurset jane furnizue me veglat si dhe me abetare per te rritun.

Tue marre parasysh kondital mas te cilat jane krye pergaditjet asht prite qe kurset ne Krahinen t'one te fillojne me punue me kohe. Gjate muejit nanduer prej maj kohe qe ka fillue puna neper kurse, shifet se fushata per likuidimin e analfabetizmit nuk zhvillohet paralelisht ne te gjitha rrethet. Me gjithe pregaditjet neper te gjitha rrethet kane qene t'organizueme mire, ket duhet t'shihmi ne rrethet e sekcjonet e arsimit dhe komisjonet per likuidimin e analfabetizmit asht edhe mos kujdesim ne punë. Puna e organizatave masovike nuk asht pergjendeme ne sasi te mjaftueshme per ngritjen e organizmeve te kurseve dhe per frekuentimin e analfabetve ne kurse. Prej saj kane rrjedhe konsekuenca shum te keqija, keshtu qe ne rrethet e Podujeves, Ferizajt, Gilanit e qytetit te Pejes gjate muejit nanduer puna me likuidimin e analfabetizmit ka pase rezultat shum te dobet.

Neper kto rrethe keshillat arsimore nuk e mbajne si duhet pergjegjesin e duhur mbi punen se tyne te shejte dhe kurrajeni se jane udheheqesa operativ. Shoqnit kulturo-arsimore dhe komisjonet per likuidimin e analfabetizmit nuk kane ndermarre kurrgja seriozisht per fillimin e punes neper kurse. E tane barra e organizimit te kurseve u-asht ngarkue puntorve arsimtare dhe organizatave themelore te Frontit popullor ne terren. Per shkak te punes pa plan fushata neper keto rrethe asht vonue, keshtu qe deri ne fund te ketij muaji rrethi i Llapit me 35 kurse analfabetike ka perfshi vetem 400 analfabete.

Edhe ne rrethin e Ferizajt gjendja nuk asht ma mire. Ketu ne 27 kurse jane perfshi vetem 600 analfabeta. Ne rrethin e Gilanit kurset analfabetike i ndjekin gjithsejt 1.200 analfabete ne 90 kurse analfabetike. Ne qytetin e Pejes jane organizue gjithsejt 14 kurse me 258 ndjekesa. Per organizimin e kurseve neper ngermarrje ne ket qytet dhe per perfshimjen e puntorve neper kto kurse. Ne lidhje me ket, sekcjoni arsimuer nuk ka marre kurrfare ndihme prej Keshillit shkollor te rrethit, gja e cila pengon fort mobilizimin e puntorve neper kurse.

Drejtorati arsimuer i Keshillit krahinuer n'ka dhane ndihmen e duhun ketyne rretheve. Instruktoret e ketij Drejtorati ne gjysen e dyte te muejit nanduer i kane vizitue te gjitha keto rrethe, tue dhane ndihmen e duhun ne terren, keshtu qe tash prej ketyne rretheve pritet qe punen per likuidimin e analfabetizmit t'aktivizojne ne marrveshtje me te gjitha organizatat masovike.

Deri sa neper kto rrethe fushata e analfabetizmit ka mbete mbrapa ne shum rrethe te tjera, kjo pune udheheqet me plan sistematik. Dhe deri tash ne kto rrethe jane korre rezultate te mira. Ne kto rrethe ne menyre ma te mire asht bashkidhe puna e organizatave masovike ne lidhje me ket fushate, dhe sekcjonet arsimore kane pase vedi pasqyren e kjarte te fushates sepse qysh me kohe kane sigurue evidencen te duhun per mbarvajtjen e fushates per likuidimin e analfabetizmit. Kjo gja ka ba te mundshme qe sekcjonet arsimore kane muejt ne cdo moment me ndihmue kurset ne punen e tyne sado larg kjo t'kishin keto.

Ne rrethin e Suharekes deri tash jane perfshi ne kurse analfabetike 70% t'analfabetve prej moshes 15—45 vjece. Qysh me kohe sekcjoni arsimuer i ketij rrethi i ka furnizue kurset me fletore dhe me lapsa. Kto kurse jane furnizue edhe me nji sasi vajguri prej disa litrash, keshtu qe puna ne kto kurse asht tue shkue mire. Gjithashtu edhe ne rrethin e Pejes jane korre rezultate te mira. Ne ket rreth asht ne nivelin e duhun edhe puna e bashkimit te shoqnive kulturo-arsimore, e cila perpos ndihmes qe u ep formave t'jera kulturo-arsimore, njikohesisht ka qene edhe organizatori i fushates per likuidimin e analfabetizmit.

Ne rrethet Dragash, Prizren, Kamenice, Gjakove si dhe ne qytetet Prizren dhe Prishtine procesi i likuidimit t'analfabetizmit asht tue u-zhvillue me plan.

Prej ketij rrjedhe qe rrethet, ku asht ecune fushata e likuidimit t'analfabetizmit t'aktivizohen ma mire dhe t'ujne kujdesin e duhun per kete. Eksperienca e vjetit te kaluem si dhe e vjetit te mparshem na tregon se puna neper kurset duhet te niset me kohe, ne qofte se mendohet t'arrihen rezultatet e duhuna, sepse kjo favorizon perforcimin organizativ te kurseve, disiplinen dhe permiresen kualitetin e punes neper keto kurse. Prandaj paraqitet si detyre e pare paralelisht me formimin e kurseve te reja te kujdesohemi per perforcimin organizativ te ketyne dhe kurseve qe kemi. Kjo gja ka me u-dhane kontributin e saj udheheqsave t'one te pakualifikuem qe gjinden ne terren.

Per realizimin e planeve per likuidimin e analfabetizmit sekcionet arsimore duhet te kene kujdesin e duhun. Ne vitin shkolluer 1948—1949 duhet t'a marrim si vjet decisiv ne likuidimin e analfabetizmit, ne qofte se sivjet rrethet e marrin ket pune me seriozitet per vjetin e ardhshem do te krijojne terrenin e gatshem per likuidimin definitiv t'analfabetizmit dhe do te hidhen ne punen e zgjanimit te rrjetes se kurseve vazhduese analfabetike dhe kurseve te nalta arsimore.

Duelen nga shtypi kater tekste shkollore ne gjuhen shqipe

Gjate muejit Nanduer e Dhetuer dulen nga shtypi dhe u-vune ne qarkullim keto tekste shkollore ne gjuhen shqipe: Abetarja per te rritun, Abetarja per klasen e I te shkollavet fillore, (botim i dyte), dhe dy librat e leximit per klasen e III e te IV te shkollavet fillore.

Abetarja per te rritun asht punue simbas metodes fonetike, me anen e serites te rritunit mesojne njikohesisht si shkronjat e shtypit, ashtu dhe ata te dores. Te mesuemit e cdo shkronje asht shoqnue edhe me figura te posacme, qe kane lidhje me mbrendian e tekstit te leximit.

Pervec pjeses s'Abetares per te mesuemit e 36 germavet te gjuhes shqipe, abetarja permban edhe shum copa leximi te ndryshme qe analfabetet, mbasi te msane shkrim e lexim, mend te lexojne ne te edhe copa leximi e te pajisen keshtu me nji kulture te pergjithshme elementare. Disa prej ketyne copave jane ma te veshtira e prandaj duhet perdore per kurset e ulta e te nalta arsimore dhe per ato te kultures se pergjithshme. Kah fundi i abetares ka edhe pak arithmetike e rregulla gjuhe, qe iu mesohen kursistave me ane shembujsh. Ka 100 faqe dhe kushton 9 dinare. Asht botue me nji tirazh prej 100.000 copesh.

Abetarja per klasen e I te shkollavet fillore asht botimi i dyte i permiresuem dhe i punuem simbas metodes se fjalevet normale, metode qe me te vertete asht pak e veshtire, sidomos per mesuesit e ri, por asht menyre ke te mesuemit qe i pershtatet psikologjise e natyres se femive te vogjel. Ky tekst, pervec pjeses se abetares, ka edhe pjesen e leximit me copa te thjeshta, me mbrendi morale e edukative, te shoqnueme edhe me figura qe kane lidhje me ato copa. Ka 106 faqe dhe kushton 10 dinare. Asht botue me nji tirazh prej 60.000 copesh.

Librat e leximit per klasen e III e te IV permbajne shum copa leximi e vjersha ne lidhje me mesimet e ndryshme te gjeografis, historis, mesimit te natyres, me ndertimin e vendit me jeten femnore pergjithesisht. Keto kane edhe kallezime te bukura me kuptime morale dhe edukative. Te gjitha keto copa leximi jane ne lidhje me programen e mesimeve te ketyne dy klasevet. Libri i klases se IV ka edhe pjese te gjata e te veshtira dhe prandaj porositet nga ana e Drejtoratit arsimuer qe te perdoret edhe neper klase te para te gjimnazeve t'ulta, deri sa te dalin per ta tekste te posacme leximi.

Keto dy tekste jane te pajisun dhe me klishe te ndryshme te bukura ne lidhje me mbrendimin e copave te leximit. Libri i klases se III-te ka 194 faqe dhe kushton 17 dinare copa. Asht botue me nji tirazh prej 30.000 copesh. Libri i klases se IV ka 286 faqe dhe kushton 26 dinare. Asht i botuem me nji tirazh prej 30.000 copesh.

Te gjitha keto tekste shkollore jane punue prej Komisjonit pedagogjik prane Drejtoratit t'Arsimit per Kosmet me nji kujdes te posacem. Me daljen e ketyne teksteve asht plotesue nji nevoje shum e madhe per shkollat fillore shqipe ne Kosove e Metohi. Nji sasi e konsiderueshme e ketyne teksteve jane dergue edhe neper shkollat shqipe ne Maqedoni Mal te Zi dhe ne Jablanice e Presheve te Serbis.

Keto tekste se shpejti do te ndiqen edhe me nji seri tekstesh te tjera si: arithmetika per klasen e III e te IV te shkollavet fillore, gjeografija per klasen e IV te shkollave fillore, Gjuha e jone (gramatika) per klasen e III, Leximi e gjendja Kine e Paris, prej Majakovskit (literature femnore) artikujt te zgjedhun pedagogjik, programa e re per shkollat fillore e te tjera per gjimnazet e ulta.

Me daljen ne drite te ketyne teksteve e librave shkollore provohet me fakte se sa fort Pushteti populluer, i udhehequn prej Partis Komuniste te Jugosllavis, kujdeset ne ngritjen kulturo-arsimore te masave shqiptare ne Kosmet.

Mbasi keto tekste e libra jane punue shpejt dhe prej pak personave te cilet kane qene t'okupuem edhe me shum e shum pune e problemet

(Vijon ne faqen e katert)

I. V. SERGEJEV

Shkenca dhe bestytnija

(Vazhdon nga numri 167)

Para njimije vjeteve shkencetari, matematicien, astronomi, filozofi dhe poeti i madh persian, Omar Khajami, tue vu ne loje ket besim te marre ka shkrue ket strofe humoristike:

Cudi, asnji'l vdekun s'u'ka nji shenje,
Asnji s'u kthye Udhen te rrefenje
Per Ferrin, per Parajsen a per hicin
Po vet's duhka cili do t'a gjenje!

(perkthen F.Noli)

Bestytnija asht boke per lloje llojesh mashtruesish e aventuristash. Sa ma forte te jete bestytnija e perhapun ne popull, aq ma i madh do te jete numeri i fallxorve, magjistarve e parazitve, qe ushqehen dhe pasunohen ne kurriz te njerezve te rrejtun e te mashtruem.

Shkenca dhe teknika i perzane paragjykimet nga vetedija e njerzvet

Revolucjoni i Tetorit i ka dhane grushtin ma te forte bestytnis. Popujt, te cilet banojne ne vendin t'one, jane clirue nga shtypja shekullore te clasifuesve, te cilet te mbajshin dhe e perkrahshin pedhanin, bestytnin dhe injorancen, ne menyre qe te mashtrojne dhe te shtypin ma lehte popullin. Ne vendin, ku te gjitha pasunit e tij, shkenca dhe teknika jane ba pronë e njerezve punues, bestytnija hjeke shpurt ma shpejt se ne cdo vend tjeter. Por ajo asht hukur larg qe te cranjoset krejtsisht, mbasi na e dijme se vetedija te njerezve mbetet bukur mire mbrapa, me ndryshimin e kushteve te jetes se tyne materiale. Shoqnija njerezore zhvillohet shum ma shpejt se c'duket bestytnija, te cila mbahet ngulitazi ne vetdijen te njeriut.

Teknika asht arme e fuqishme per luftimin e bestytnis, e cila rrnet kudo deri edhe ne skajet da te largeta te Bashkimit Sovjetik.

Ne veren e vjetit 1940 ne Pamir ka qene ndertue nji rruge fort e mire, qe lidhte kryeqytetin e Taxhikistanit — Stalinabad — me katundet malore te largta — kishlaket, deri atehere te ndame prej bote.

Kur mbriti automobili i pare ne kishlak, i cili shtrihej nalte mbi re, rreth maqines u mbledhen banoret. Ata kurre s'kishin pa automobil dhe me frige e shiqojshin „bishen" e cuditshme e te pakuptueshme: motori nuk ishte fike, automobili rroptonte e llambat e tij shendritshin si dielli.

Mbrenda nji ko'te te shkurt banoret kishlak e kuptojne ma, se kjo "bishe" asht e qete dhe nuk sulmon kerkend. Ata te cilet ishin ma guximtar iu afruen kamjonit dhe filluen me i vrejte me kujdes rrotat e tij, feshinte plahuin e randiatorve me lesha te tyne, qe te shihen ma mire llambat te tij. Gjorshtaket kane qene te bindun se llampat ishin sy, dhe vecanerisht jane mrekullue prej kuptimit shtesuer, mbasi dijshin se ata ia shendritshin vetvehtes rrugen me sy. E nji plak, tue dashte me e prite mire e me i ba muhabet automobilit, i sjelli nji krah terfoje, ne menyre qe mesafiri te kete me ngrane, mbasi te shkretit automobil i asht mundue derisa e kane ngrehe gjithe ate borre ne ato male aq te nalta!

Mbas disa ditve kjo lloj komunikacjoni i rregullt n'ate udhe, keshtu automobilat bahen nji dukuni e zakonshme. E tash e mbrapa nuk u bjen kurkush jansdac (terfoje). Gorshtaket e kuptojne se automobili s'asht shtaze, se ai s'ka mendje te vehten, e se te gjitha aftesite e tij i ka krijue njeriu; madje plakat mikpritese fillojne me e perqeshe ase fillojne me gezohene rreth tij gjithfare ordinatash.

Automobili nder keto malsina te nalta ka qene nji dukuni e jashtezakonshme, e prandaj edhe te tmerrshme. Por, me gjithe ate nuk ka krijue kurrfare bestytnije, sepse njerzit e rrethit me gjithe zemer u kane spjegue, se si asht ndertue automobili, se si ai punon, tue u perpjeke qysh prej fillimit t'a zhdukin cdo lloj paraqitje te bestytnis mbi teknikan.

Kete duhet me te vue ne dukje vecanerisht, mbasi deri ne revolucjon shum prej banoreve t'Azis Qendrore e kane pase pagesuh bekurudhen „shejtan-araba" (kerri i dreqit). Jo pernjaherë, por kane kujtue seriozisht se kjo maqine levize sepse njerzit dinake rrase kane mbrrijte me e mbylle shejtanin ne qerden e bekurt (araba), d. m. th. dreqin.

Parafytyroni, se sa tjale te koqija kane qene perhap mbi traktorat; kur per te paren here, jane cfaqe ne fushat t'ona. Kulaket dhe njerzit e mbrapambetun, te cilet aprovojshin se gjoja do te prishin token, se mbas tyne toka s'ka me prodhue, se ajo asht maqina e dreqit, shpikja e dreqit, qe don me e prish token. Dhe kjo s'ka ndodhe nder vende t'egra e te vetmohueshme, ne ponir, n'Afrike, por neper katundet Ruse, te kjo jo ma larg se 15 — 20 vjete perpara. Sikur te na vinte si me te themi, i ati i ndonji studenti qe demonte zotin e gjuetis, ose ndonji banor i ishullit, i cili adhuron bujashken „foise", ata neve do te na kujtojshin prallnore, magjistar, ashirbamest!

Mbasi na me nji te prekun gishti e shperndajme errsinen dhe e ndezim nji drite aq te forte si te verboi syt porsi dielli. Mbasi me nji levizje te dores — e cila prek murin — mundemi me shkaktue e nji shi te pasosur uji. Mbasi na mundemi me shkue prej nji vendi ne nji tjeter e ne rruge te 'late pa kal, n'uje - pa ndihmen s'one, n'ajer-pa krah. Mundemi me notue ne thellsinat t'ujit, te fluturojme me nji za te gjatshem ne ndenjze, qe te na ndijne n'skajin tjeter te botes. Mundemi me i marre vesh ndendjenet e njerzeve te medhaj, qe kane deke perpara njimije vjetve. Mundemi me pa ate se cka ngjet ne ket cas larg me qinda kilometer prej nesh. E ne qofte se dishrojme, mundemi me ndi zanin e njerezve, qe kane deke para dhetesha vjetesh, dhe jo vetem te ndijme zanin e tyne por edhe t'i shohim ata njerez.

Por nji njeri te nji kulture tjeter, i cili nuk e ka iden mbi elektricitetin, ujsjellsin, automobilin, anijen, aeroplanin, nendetsen, radion, librin, tekvizionin, kineman, - te gjitha keto per te jane cudina. Por kjo per ne asht teknika, te cilen e krijoi shkenca, cila asht ba e aferi per te gjith qytetat e atdhent t'one te madh.

Tue e munde frigen te bestytnis para fuqive te imershme te natyres, men dja hulumtuese e njeriut Qysh prej kohe ka anue me u fut ne ndertimet misterioze te botes. Prej shekullit ne shekull populli ka vazhdue natyren dhe ka mbledhe prej saje shum vereje te cmueshme. Me sheja te vecanta ka muejt shum e pak me parafytyrue kohen. Ne saje t'eksperienca shekullore, ai njofti vecorit e shum bimeve dhe filloi t'i perdori, jo vetem per ushqim, por edhe per barna mjekesore.

Por ai vertetun vetem lidhjen e caktueme ndermjet vrejtjes se tij dhe se ketij apo t'atij fenomeni te natyres. Ai s'ka muejt me e spjegue, pse nuk i ka kuptue shkaqet e saja. Ai ka vu re, per shembull, se krypa perpara se me ra shi, lagshtohet. E pse? Ai ka vu re, se qofte dallandyshet fluturojne per toke ka me ra shi. E pse? Ai kete s'e ka dijte.

Shkenca i asht pergjegje ne mija pyetjeve. Perpara se me ra shi, shtypja atmosferike bjen poshte, lagshtija e ajri shtohet. Krypa e thith lagshtinen shum lehte e prandej lagshtohet shpejt. Shtimin e lagshtis s'ajri i detyron mizat e vogla te cilat rrijne nalte per mbi dhe qe te bijne poshte. E mbasi dallandyshet ushqehen me miza, per ket shkak edhe ata detyrohen me ra poshte.

(vazhdon)

Lajme nga bota e jashtme

Letra e minatoreve francez keshillit central te sindikatave t'unjisueme te Jugosllavis

Keshilli central i sindikatave t'unjisueme te Jugosllavis ka marre prej bashkimit te minatoreve te Frances nji leter ne te cilen [illegible] 10 mijgn [illegible]

Te dashtun shoke,

[illegible]

Trupat e Kuomintangut te rrethueme afer Hsuçonit kane humbe 100.000 njerez

[illegible]

(Vijon nga faqja e trete)

[illegible]

Grevat gjenerale te puntoreve ne provincen Mesina

Grevat kane shkaktue ndalimin e qarkullimit te tramvajave dhe te trolejbuseve ne Palermo

[illegible]

—o—

Grevistat minatore ne Sardenja nuk leshojne horizontet minatore

[illegible]

Qeverija e Kejit ka kufizue te drejtat kushtetuese te popullit francez

[illegible]

Njisit e Armates Demokratike te Greqis kane hye ne qytetin Kardiq ne Theseli

[illegible]

—o—

Ekspertat amerikane po e studjojne mundesin e armatimit perseri te Japonis

[illegible]

Burgimi i udheheqesave te shtetit dhe i funksionereve te Partis ne Shqipni

[illegible]

Ne luftimet mbrenda dy muejve luftetaret e Armates Demokratike Greke kane mbrrijte suksese te mdha

Radio stacjoni Greqia e lire n'emisjonin e vet te dates 13 te ketij mueji ven ne dukje rezultatet e korruna ne luftimet dy mujore te zhvillueme me gara luftarake te njisive t'Armates demokratike te Greqis, te cilat jane organizue me rastin e dy-vjetorit te themelimit te Komandes Supreme t'Armates Demokratike. Garat kane marre fund me 20 nandorr si shperblim per rezultatet te korruna ne gara kane qene flamuri i Kuq, diplomat dhe dekoracjonet.

Simbas rezultateve te mbrrijtuna Shtabi Suprem i Armates Demokratike te Greqis e ka shpalle per ma te mirin Divizjonin e XI-te, te cilit i ep flamuri i kuq. Njisit e ketij divizjoni kane marre pjese ne rimarrjen e kodrines Kulla-Pilati. Ato kane marre pjese ne 15 luftuna te mdhaja ofensive dhe 148 luftime ma te vogla. Gjate ketyne operacjoneve armiku ka pase 833 te vdekun, 1.458 te plagosun dhe 122 te zanun robe. Luftetaret e Divizjonit XII-te kane ngujue 160 kamjona t'armikut, 6 tankat dhe sasina te mdhaja materjali tjeter luftarak dhe armesh. Perveç kesaj Divizjoni i XI-te asht shque edhe ne punen kulturo-propagandistike. Ushtareve t'ushtris monarko-fashiste u jane dhane nga luftetaret e ketij Divizjonit 72.150 broshura te shtypuna me permbajtje propagandistike. Divizjoni asht shque gjithashtu edhe ne punen politike, organizative.

Mbas divizjonit XI-te jane shque gjithashtu ne garat luftarake edhe divizjonet e poshtshenueme: i IX-ti, i I-ri, i VIII-ti, i X-ti, i VII, i XV-ti, i III-ti dhe divizjoni i II-te. Ne garat ne mes te brigadave asht shque si ma e mira brigada e XX-te e Maqedonis Qendrore dhe brigada e XVIII-te e Divizjonit XX-te.

Gjate ketyne garave dymujore njisit e Armates Demokratike, te cilat jane shque, kane ba gjithsejt 271 luftime me perpjestime ma te mdhaja dhe 670 perleshje. Ne ket perudhe monarko-fashistat kane humbe 4.657 te vdekun, 5,623 te plagosun dhe 704 ushtare te zanun rob. Ne keta dy [illegible]

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miladin Popoviq„ Prishtine.
Pajtimet ne fletoren i pranon Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906030.